



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government



Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit-Ministarstvo za kulturu, omladinu i sport-Ministry of Culture, Youth and Sports
Departamenti i Kulturës/Departman za kulturu/Department of Culture

POLITIKAT PROGRAMORE 2016
DEPARTAMENTI I KULTURËS
DIVIZIONI I ARTEVE SKENIKE MUZIKORE PAMORE (VIZUELE) – KODI: 803

QËLLIMI

Departamenti i Kulturës krijon politikat programore sipas vlerave dhe mekanizmave që hapin rrugën zhvillimit të kulturës. Këto politika janë në shërbim të institucioneve kulturore, ngritjen e nivelit artistik duke krijuar kushte për ngushtuar rrethin e vlerave triviale. Veçanërisht atyre të cilat morën hovë pas periudhës së de institucionalizimit. Në Departamentin e Kulturës hartohen dhe zbatohen politika zhvillimore sipas standardeve evropiane, duke e konsideruar kulturën si një mekanizëm me ndikim në zhvillimin dhe afirmimin e identitetit kulturor të Kosovës dhe përafrimin e saj brenda identitetit kulturor evropian.

OBJEKTIVAT

Departamenti i Kulturës krijon mjedis mbështetës për zhvillimin bashkëkohor të arteve skenike muzikore e pamore, artit të shkruar, botimit të librave si dhe promovimin e saj me vlera të mirëfillta dhe aftësisë konkurruese në vend dhe në arenën ndërkombëtare; si dhe të promovojë diversitetin kulturor, pastaj karakterin shumë-etnik të Kosovës në kuadër të proceseve integruese evropiane.

Aktivitetet që kërkohen për t'i arritur objektivat e lartpërmendur në aspektin legjislativ janë:
Zbatimi i programit të decentralizimit dhe konsolidimi i institucioneve të artit dhe të kulturës në nivel kombëtar;
hapja e kodeve të veçanta buxhetore;
Hartimi i Strategjisë së Zhvillimit të Kulturës 2016-2020
Ndryshim-plotësimi i Ligjit për Kinematografinë;
Hartimi i statuteve të institucioneve që ende nuk i kanë realizuar;
Nxjerrja e rregulloreve dhe akteve nënligjore të institucioneve vartëse që dalin nga ligjet përkatëse.

DIVIZIONI I ARTEVE SKENIKE-MUZIKORE DHE PAMORE (VIZUELE)

Divizioni i Artet Skenike-Muzikore dhe Pamore përbëhet prej katër sektorëve:

- Sektori i arteve muzikore
- Sektori i arteve vizuele
- Sektori i arteve skenike-teatri
- Sektori i kinematografisë-filmi

QËLLIMI

Politikat programore të DASMP-ës kryesisht kanë për qëllim mbështetjen institucionale për institucionet kulturës në aspektin financiar, ligjor, administrativ, menaxhues dhe të infrastrukturës. Pastaj sfida tjetër mbetet realizimi sa më i suksesshëm i plan-programit dhe ngritjes profesionale të individëve sipas standardeve evropiane.

Institucionet kulturor e të cilat janë nën ombrellën e Departamentit të Kulturës dhe të DASMP janë këto:

- Teatri Kombëtar i Kosovës;
- Filarmonia-Opera e Kosovës;
- Baleti i Kosovës;
- Ansambli KKV "Shota";
- Galeria e Arteve Kosovës;
- Qendra Kinematografike e Kosovës, dhe
- KosovaFilmi.

REFORMAT NË INSTITUCIONET E KULTURËS

Këto institucione duhet të kërkojnë një ridefinim të objektivave dhe strukturave të tyre organizative dhe funksionale, në bazë të Ligjit të ri për teatrot, dhe në bashkëpunim të përhershëm me Departamentin e Kulturës dhe Divizionin e DASMP-ës/MKRS.

KOMUNIKIMI

Kontaktet ndërmjet institucioneve duhet të jenë të vazhdueshme për t'i këmbyer informatat e tyre rreth realizimit të instruksioneve dhe reformave që dalin nga Ministria e Kulturës dhe ligjeve të institucioneve kulturore në Kosovë. Koordinimi duhet të zhvillohet, gjithashtu, nga Departamenti i Kulturës dhe Divizioni i Arteve Skenike-Muzikore e Pamore, bazuar në përvojat të tyre me partnerët tjerë, si: Ministrinë dhe Institucionet tjera kulturore përkatëse.

PËRGJEGJËSITË

Drejtorët e institucioneve kulturore me përgjegjësi të plotë bëjnë prezantimin sa më të mirë dhe të suksesshëm të institucionit të vet, duke realizuar plan-programet e tyre vjetore, duke respektuar rregullat administrative dhe financiare sipas ligjeve në fuqi, inventarizimin e rregullt vjetor, si dhe të bëjnë vlerësimin e rezultateve të secilit punëtor dhe të institucionit, në mënyrë objektive dhe të drejt, për të vetmin qëllim, të ngritjes së institucionit në nivel sa më të lart artistik dhe profesional.

BUXHETI BAZË

Të ardhurat personale (stafi administrativ dhe artistik), —100% nga Buxheti i Kosovës;
Shpenzimet materiale 100 % nga Buxheti i Kosovës;
Puna sistematike (aktivitetet), 50-100% nga Buxheti i Kosovës;
Projektet 50% do të mbështeten nga donatorët e tjerë të mundshëm.

SEKTORI I ARTEVE SKENIKE-TEATROT

QËLLIMI

Sektori i Arteve Skenike synon zhvillimin e fushës së teatrit kombëtar dhe integrimin e saj në rrjedhat ndërkombëtare.

Metodat për arritjen e zhvillimit të sektorit janë:

Zbatimi i Ligjit të ri për Teatrot, hartimi i statuteve, akteve nënligjore dhe udhëzimeve administrative si: në Teatrin Kombëtar të Kosovës, teatrot publike të qyteteve etj.; ngritja e aftësive menaxhuese profesionale të teatrove; gjenerimin e mjeteve vetjake; përkrahja e projekteve me interes kombëtar në artet skenike-teatër; promovimi i krijimeve të reja skenike në fushën e teatrit; përmirësimi i

komunikimit dhe i bashkëpunimit të TKK-së me teatrot tjera të Kosovës; ngritja e kapaciteteve profesionale dhe freskimi me anëtarë të rinj të teatrove; krijimi i hapësirës fizike për punë efikase të teatrove (investimet kapitale); përkrahja e Festivaleve tradicionale dhe ndërkombëtare të teatrove në Kosovë; shkëmbimi i vlerave teatrore në rrafshin kombëtar dhe ndërkombëtar; MKRS/DK për çdo vit të ndanë Çmimin Kombëtar për Vepër Jetësore dhe Çmimeve Vjetore për teatër, sipas Rregullores në fuqi.

TEATRI KOMBËTAR I KOSOVËS				
Programet	Buxheti i shpenzuar për vitin 2015	Buxheti i kërkuar për vitin 2016	Buxheti i propozuar për vitin 2016	Buxheti aprovuar nga Ministri për vitin 2016
Shpenzimet për funksionalizimin e TKK-ës dhe për honorarët për anëtarët e Këshillit Artistik dhe të Këshillit Drejtues.	25,000 €		25,000 €	20,000 €
Puna sistematike aktivitetet dhe projektet	275,000 €		320,000 €	320,000 €
TOTALI	300,000 €	451,000 €	345,000 €	340,000 €

Aprovuar nga:

Sekretari i përgjithshëm



Veton Firzi

Ministri i MKRS



Kujtim Shala

SEKTORI I ARTEVE SKENIKE- MUZIKORE

QËLLIMI

Sektori Arteve Skenike-muzikore synon zhvillimin dhe promovimin e këtij arti drejtintegritit në skenave kombëtare dhe ndërkombëtare.

Metodat për arritjen e zhvillimit të sektorit janë:

Vazhdimi i punëve në ndërtimin e Objektivit për Teatër dhe Operë "Dr. Ibrahim Rugova"; Promovimin e krijimtarisë muzikore në të gjitha zhanret; Promovimi i vlerave në rrafshin kombëtar dhe ndërkombëtar, në mënyrë reciproke; Në ngritjen e institucioneve të reja si dhe forcimin e atyre ekzistuese; Zgjerimin e Orkestrës së Filarmonisë dhe Operësme kuadro që mungojnë; Mbështetje dhe menaxhimin e mirë të Ansambllit "SHOTA"; Shkollimin e koreografëve të baletit; Mbështetjen e festivaleve të muzikës serioze, argëtuese, xhazit, koreve profesionale; Mbështetja e festivaleve muzikore të zhanreve të ndryshme; Forcimin e shkollës së baletit me kuadro të nevojshme; Përkrahja, ruajtja dhe avancimi i festivaleve të muzikës tradicionale; Kultivimi i vlerave të muzikës korale; MKRS/DK për çdo vit të ndanë Çmimin Kombëtar për Vepër Jetësore "Niketë Dardani" dhe Çmimet Vjetore në fushën e muzikës, sipas Rregullores në fuqi.

Institucionet në artet skenike-muzikore janë:

- Filarmonia-Opera e Kosovës;
- Baleti Kombëtar i Kosovës;
- Ansambli Kombëtar i Këngëve dhe Valleve "Shota"

FILARMONIA E KOSOVËS				
Programet	Buxheti i shpenzuar për vitin 2015	Buxheti i kërkuar nga FK për vitin 2016	Buxheti i propozuar nga DK për vitin 2016	Buxheti i aprovuar nga Ministri për vitin 2016
Shpenzimet për funksionalizimin e Filarmonisë dhe për honorarët për anëtarët e KD	15,000 €		15,000 €	15,000 €
Puna sistematike aktivitetet dhe projektet	190,000 €		230,000 €	230,000 €
TOTALI:	205,000 €	354,000 €	245,000 €	245,000 €

OPERA E KOSOVËS				
Programet	Buxheti i shpenzuar për vitin 2015	Buxheti i kërkuar nga OK për vitin 2016	Buxheti i propozuar nga DK për vitin 2016	Buxheti i aprovuar nga Ministri për vitin 2016
Shpenzime për punë sistematike aktivitetet dhe projekte	78,000 €	78,000 €	70,000 €	70,000 €
TOTALI	70,000 €	70,000 €	70,000 €	70,000 €

BALETI I KOSOVËS				
Programet	Buxheti i shpenzuar për vitin 2015	Buxheti i kërkuar nga BK për vitin 2015	Buxheti i propozuar nga DK për vitin 2016	Buxheti i aprovuar nga Ministri për vitin 2016
Shpenzimet për funksionalizimin e Baletit dhe për honorarët e anëtarëve të KD	20,000 €	20,000 €	20,000 €	20,000 €
Puna sistematike aktivitetet dhe projektet	160,000 €	250,446 €	185,000 €	185,000 €
TOTALI	180,000 €	270,446 €	205,000 €	205,000 €

ANSAMBLI KOMBËTAR I KËNGËVE DHE VALLEVE "SHOTA" – AKKV "SHOTA"				
Programet	Buxheti i shpenzuar për vitin 2015	Buxheti i kërkuar nga AKKV "Shota" për vitin 2015	Buxheti i propozuar nga DK për vitin 2016	Buxheti i aprovuar nga Ministri për vitin 2016
Shpenzimet për funksionalizimin e AKKV "Shota" dhe për honorarët e anëtarëve të KD	20,000 €		20,000 €	20,000 €
Puna sistematike aktivitetet dhe projektet	120,000 €		135,000 €	135,000 €
TOTALI	140,000 €	350,790 €	155,000 €	155,000 €

Aprovuar nga:

Sekretari i përgjithshëm



Veton Firzi

Ministri i MKRS



Kujtim Shala

SEKTORI I ARTEVE VIZUELE

QËLLIMI

Në kuadër të sektorit synohet zhvillimi i fushës së arteve figurativevizuale dheintegrimin e Galerisë Kombëtare e Kosovës në rrjedhat Evropiane dhe Botërore, institucion ky i rëndësisë së veçantë për kulturën tonë. Galeria e Ministrisë së Kulturës "Qafa" po ashtu do të merret me organizmin e ekspozitave, të krijuesve vendor, të diasporës dhe të huaj konform politikave programore.

Metodat për arritjen e zhvillimit të sektorit janë:

Të krijohen kushte sa më të volitshme financiare;të hartohen të gjitha rregulloret e brendshme të punës;

Në bashkëpunim me drejtorët e komunave të Kosovës, të nxiten iniciativat për themelimin e qendrave të reja të artit;

Të krijohen kushtet për prezantimin e artit vizual në arenën ndërkombëtare;Të ngritën kapacitetet për

avancimin e vlerave profesionale.

GALERIA E ARTEVE TË KOSOVËS				
Programet	Buxheti i shpenzuar përvitin 2015	Buxheti i kërkuar nga GAK për vitin 2016	Buxheti i propozuar nga DK për vitin 2016	Buxheti i aprovuar nga Ministri për vitin 2016
Shpenzimet për funksionalizimin e GAK dhe për honorarët e anëtarëve të Këshillit Drejtues	20,000 €		20,000 €	20,000 €
Puna sistematike aktivitetet dhe projektet	120,000 €		135,000 €	135,000 €
TOTALI	140,000 €	196,000 €	155,000 €	155,000 €

GALERIA E MINISTRISË SË KULTURËS "Qafa"

Të planifikohet dhe të financohen të gjitha ekspozitat që realizohen në Galerinë "Qafa": shtypja e katalogut, aranzhimin e ekspozitës dhe koktejin;Me programin vjetor të Galerisë "Qafa" të përzgjedhur nga Juria profesionale, duhet të përkrahen projektet e shoqatave të artistëve, iniciativave alternative dhe amatore, individëkrijues, OJQ-ve, të cilat janë në funksion të artistëve të rinj.

Galeria e Ministrisë së Kulturës "Qafa"				
Programet	Buxheti i shpenzuar përvitin 2015	Buxheti i kërkuar nga G. "Qafa" në 2016	Buxheti i propozuar nga DK për vitin 2016	Buxheti i aprovuar nga Ministri për vitin 2016
Honorarët e Jurisë seleksionuese e ekspozitave	1,500 €		2,000 €	2,000 €
Puna sistematike aktivitetet dhe projektet	23,500 €		26,500 €	26,500 €
TOTALI	25,000 €	30,000 €	28,500 €	28,500 €


Aprovuar nga:

Sekretari i përgjithshëm



Veton Firzi

Ministri i MKRS



Kujtim Shala

ARTI I FILMIT-KINEMATOGRAFIA

QËLLIMI

Të mbështesë prodhimin dhe zhvillimin e filmit kosovar dhe riaktivizimin e kinemave në Republikën Kosovë. Ekzistojnë disa kinema që funksionojnë në Kosovë; ndërkaq kinemaja ABC në Prishtinë i përmbush standardet.

Metodat për arritjen e zhvillimit të sektorit janë:

Përfundimi i hartimit të Ligjit të ri për Qendrën Kinematografike të Kosovës; Xhirimi i filmave në Kosovë; Ringjallja e prodhimit të filmave lokal, duke inkurajuar producentët lokal, menaxherët dheskenaristët që të konceptojnë dhe të zhvillojnë filma të metrazhit të gjatë, dokumentarë dhe të animuar; zhvillimi i një sistemi të standardizuar dhe modern për distribuimin e filmave në Kosovë; Rinovimin e objekteve të amortizuara dhe gjysmë të rrënuara, dhe krijimin e kushteve sa më të favorshme hapësinore dhe teknike të kinemave ekzistuese për shfaqjen e filmave, në bashkëpunim me Komunitetin;

Strategjia

Ministria ka një strategji me ide të shumta për të zhvilluar xhirimin, distribuimin dhe ekspozimin e filmave. Të gjitha sallat e filmit (kinematë) të transformohen nga pronësia shoqërore në sektor privat; si dhe institucionet e distribuimit dhe shfaqjes së filmave duhet të transformohen në ndërmarrje komerciale. Duke dhënë resurse financiare brenda Kosovës, xhirimi i filmave jo gjithmonë mund të jetë i realizueshëm, prandaj qeveria duhet të jetë e aftë që sistematikisht të ofrojë përkrahje për xhirimin e filmave, duke marrë shembull nga shumë vende të rajonit dhe ato evropiane.

Metodologjitë e implementimit

Xhirimi - QKK-ja përkrahë sektorin privat ose të pavarur, bashkë-prodhimin, apo financim të plotë të xhirimit. Për skenaristët, menaxherët dhe prodhuesit rinj të filmave duhet të ofroje asistencë profesionale në formë të ndryshme;

Distribuimi - Ministria dhe QKK do të zhvillojnë një sistem për të licencuar distribuimin e filmave dhe njëkohësisht do të inkurajojë distributorët privat.

Institucionet - Qendra Kinematografike e Kosovës do të bëjë ndarjen e buxhetit për xhirimin e filmave të ri, si institucion profesional dhe ligjor. Njëkohësisht do të realizojë monitorimin e prodhimeve nga xhiruesit e filmave, nëpërmjet stafit profesional.

Metodat për arritjen e zhvillimit të sektorit janë:

Çdo shtëpi prodhuese e filmit, duhet të konkurroj në Qendrën Kinematografike të Kosovës, të përcaktuara me konkurs publik.

Partnerët

Sektori Privat, siç janë kompanitë për xhirimin dhe distribuimin e filmave komercial dhe dokumentarë; Agjensioni Kosovar i Privatizimit dhe Komunitat;

Financimi

Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, sektori privat, donatorët vendor e ndërkombëtar, dhe palët tjera të interesuara.

QENDRA KINEMATOGRAFIKE E KOSOVES - QKK				
Programet	Buxheti i shpenzuar për vitin 2015	Buxheti i kërkuar nga QKK për vitin 2016	Buxheti i propozuar nga DK për vitin 2016	Buxheti i aprovuar nga Ministri për vitin 2016
Shpenzime për funksionalizimin e Qendrës dhe për honorarët e anëtareve të KD-së të QKK	40,000 €	228,500 €		
Xhirimi i filmave dhe projektet	710,000 €	1,695,000 €	740,995 €	740,995 €
TOTALI	750,000 €	1,923,500 €	740,995 €	740,995 €
KOSOVAFILMI				
Programet	Buxheti i shpenzuar për vitin 2015	Buxheti i kërkuar nga KOSOVAFILMI për vitin 2016	Buxheti i aprovuar nga DK për vitin 2016	Buxheti i aprovuar nga Ministri për vitin 2016
Aktivitete			10,000 €	10,000 €
TOTALI			10,000 €	10,000 €

Aprovuar nga:

Sekretari i përgjithshëm



Veton Firzi

Ministri i MKRS



Kujtim Shala

NDARJA E ÇMIMEVE PËR VEPËR JETËSORE DHE VJETORE, PËR TEATËR, DRAMËN SHQIPTARE, MUZIKË, LETËRSI DHE KINEMATOGRAFI, SI DHE PAGESA E JURIVE DHE TË FITUESËVE TË KËTYRE ÇMIMEVE BËHET SIPAS RREGULLOREVE NË FUQI


ÇMIMI PËR TEATËR PËR VITIN 2015						
Emri i Çmimeve	Çmimi për vepër jetësore 2015	Çmimi vjetor për shfaqjen më të mirë	Çmimi vjetor për regjinë më të mirë	Çmimi vjetor për aktorin më të mirë	Çmimi për prezantimin e suksesshëm ndërkombëtar	Totali
Shumat	6,500 €	2,500 €	2,500 €	2,500 €	2,500 €	16,500 €
Pagesa e Jurisë	400 €	400 €	400 €	400 €	400 €	2,000 €
Vërejtje: pagesa e shumave për çmimet për teatër do të bëhet nga kodi 805					Totali: 8,500 €	

ÇMIMI "KATARINA JOSIPI" PËR VITIN 2015						
Emri i Çmimit	Vendi i parë		Vendi i dytë	Vendi i tretë		Totali
	3,600 €		2,200 €	1,600 €		7,400 €
Pagesa e Jurisë	200 €	200 €	200 €	200 €	200 €	1,000 €
Vërejtje: pagesa e shumave për çmimet për K. Josipi" do të bëhet nga kodi 805					Totali: 26,900 €	

ÇMIMI PËR MUZIKË "NIKETË DARDANI" PËR VITIN 2015						
Emri i Çmimeve	Çmimi për vepër jetësore	Çmimi vjetor për vepra vokale instrumentale e skenike	Çmimi vjetor për vepra simfonike koncertale	Çmimi vjetor për veprat kamertale	Çmimi vjetor për veprat të muzikës korale	Shuma
Shumat	5,000 €	7,000 €	5,000 €	3,000 €	2,000 €	22,000 €
Pagesa e Jurisë	500 €	500 €	500 €			1,500 €
Vërejtje: pagesa e shumave për çmimet për muzikë do të bëhet nga kodi 805					Totali: 23,500 €	

ÇMIMI PËR KINEMATOGRAFI "BEKIM FEHMU" PËR VITIN 2015						
Emri i Çmimeve	Çmimi për Vepër jetësore	Çmimi vjetor për njërin nga: rolin, regjinë, skenarin, kostumet, muzikën apo skenografinë më të mirë				Totali
Shumat	5,000 €	2,500 €				7,500 €
Pagesa e Jurisë	200 €	200 €	200 €	200 €	200 €	1,000 €
Vërejtje: Pagesa e shumave për çmimet për kinematografi do të bëhet nga kodi 805					Totali: 8,500 €	

Hartuar dhe rekomanduar nga:
U.D. i drejtorit të Departamentit të Kulturës


Sami Piraj

Aprovuar nga:

Sekretari i përgjithshëm


Veton Firzi



Ministri i MKRS


Kujtim Shala

Prishtinë, 19.01.2016